



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 155 Akti

Nr. 193 Vendimi

Tiranë, më 06.09.2019

V E N D I M

Trupit gjyqes i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

në prezencë të vëzhgueses ndërkombëtare, z. Mia Roessingh, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në datën 2 shtator 2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Sokol Ibi, gjyqtar/kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ibi, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Z. Sokol Ibi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si kryetar/gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Z. Sokol Ibi, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.5.2018, me trupin gjyqes të përbërë nga komisionerët:

Olsi Komici	Anëtar
Xhensila Pine	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar me vendimin nr. 1, datë 17.5.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 1.7.2019, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ibi, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 4.7.2019, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit: mbi të drejtën për të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 10.7.2019; subjekti ka paraqitur me *e-mail* kërkesë për shtyrje të afatit për të paraqitur prova dhe shpjegime.

7. Në datën 16.7.2019, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Ibi, për shtyrjen e afatit të shpjegimeve deri në datën 27.8.2019.

8. Në datën 29.8.2019, me vendimin nr. 4, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ibi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 2.9.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ibi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 2.9.2019 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 2.9.2019 u ndërpre, për të vazhduar në datën 6.9.2019, me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

A. VLERËSIMI I PASURISË

11. ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Ibi, duke krahasuar: deklaratën e pasurisë "Vetting"; deklaratat e pasurisë në vite; dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jobankar etj, të dorëzuara nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me korrespondencën me nr. *** prot., datë 3.7.2017, pranë institucioneve publike.

ILDKPKI-ja në përfundim të veprimeve verifikuese bazuar në nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

A/1 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

12. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; për verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e deklarimeve të rremë, apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku rezulton se:

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, z. Sokol Ibi, ka deklaruar:

I. Shtëpi banimi me sip. 127 m², dhe truall me sip. 324 m², ndodhur në fshatin ***, Pogradec, e blerë në datën 19.8.2002.

Tokë bujqësore me sip. 1040 m², blerë në datën 19.8.2002, ndodhur në fshatin ***, Pogradec.

Tokë bujqësore me sip. 996 m², blerë në datën 19.8.2002, ndodhur në fshatin ***, Pogradec.

Tokë bujqësore me sip. 2050 m², blerë në datën 19.8.2002, ndodhur në fshatin ***, Pogradec.

Tokë bujqësore me sip. 2240 m², blerë në datën 19.8.2002, ndodhur në fshatin ***, Pogradec.

Burimi i krijimit: Të ardhurat e siguruara nga puna si i vetëpunësuar në bujqësi si anëtar i familjes bujqësore. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

13. Faktet nga hetimi administrativ

13.1 Bazuar në aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP) me nr. ***, datë 27.3.1992, babai i subjektit të rivlerësimit, z. B.I., si kryefamiljar ka përfituar tokë bujqësore me sip. 9790 m².

13.2 Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaron se ka blerë me kontratën e shitblerjes së datës 19.8.2002, edhe tokë arë me sip. 6326 m². Kjo pasuri nuk është deklaruar në deklarin e vitit 2006. Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaron tokë bujqësore me sip. 3464 m², përfituar në bashkëpronësi me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore. Pjesa takuese: 25 %.

13.3 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, viti 2006, subjekti ka deklaruar truall me sip. 324 m² dhe shtëpi banimi me sip. 127 m² në truallin e mësipërm, ndodhur në ***, Pogradec, fituar në vitin 2002, në vlerën 100.000 lekë. Subjekti në vitin 2006 deklaron si pjesë takuese 25 % në tokën bujqësore me sip. 9790 m², përfituar nga ligji nr. 7501/1991 “Për tokën”.

13.4 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 18.9.2014, subjekti deklaron se ka blerë shtëpinë dhe truallin në vlerën 100.000 lekë, si dhe ka përfituar tokë bujqësore me sip. 9790 m², pjesa takuese, 25 %, duke mosdeklaruar blerjen e një pjese të kësaj toke bujqësore, apo ndarjen e saj.

13.5 Me përgjigjet e pyetësorit të datës 3.6.2019, pasi u pyet nga Komisioni, subjekti deklaroi se: “Në kufirin verior të banesës sime ka një ndërtim të bërë para vitit 1990 nga babai im B.I., i cili i ka shërbyer babait si depo për dru dhe i tillë i shërben edhe aktualisht. Kjo pasuri e babait tim nuk figuron e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, se nuk është hedhur në sistem nga grupi i punës në regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme”.

13.6 Ky ndërtim nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit, por vetëm në pyetësorin e datës 3.6.2019, pasi subjektit iu kërkua të shpjegoje nëse ka ndërtim tjetër pranë banesës së tij dhe kujt i përket ky ndërtim.

13.7 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për:

-mospërputhje deklarimesh midis deklaratave periodike me deklaratën “Vetting” për pasurinë arë, përfituar me kontratën e shitblerjes së datës 19.8.2002;

-mosdeklarim të ndërtimit të babait, ndodhur në pronën e subjektit, përveçse kur u është kërkuar nga Komisioni, konfirmim nëse ka ndërtim tjetër pranë banesës së tij;

-per sa në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 18.9.2014, subjekti nuk ka deklaruar se sip. 6326 m² nga toka bujqësore e familjes, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, përfituar me kontratën e shitblerjes së datës 19.8.2002.

14. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision, subjekti i rivlerësimit shpjegoi sa më poshtë:

14.1 Në lidhje me mospërputhjen e deklarimeve për pasurinë arë të përfituar në datën 19.8.2002

14.1.1 Subjekti pranoi se ka mospërputhje midis deklarimit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, me deklaratën “Vetting”, lidhur me tokën arë të përfituar, jo në sipërfaqen e tokës bujqësore, e cila në të dyja deklaratat është deklaruar në total me sip. 9790 m², por pjesën takuese që zotëron, në këtë sipërfaqe.

14.1.2 Kjo mospërputhje kishte rezultuar pasi në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2006, lidhur me deklarimin e tokës bujqësore subjekti kishte çmuar se duhet të deklaronte të gjithë sipërfaqen e tokës bujqësore si dhe burimet e të krijimit në origjinë.

14.1.3 Në procesverbalin datë 18.9.2014, të mbajtur me subjektin në ILDKPKI, lidhur me tokën bujqësore, nuk është konstatuar pasaktësi lidhur me deklarimin e tokës bujqësore dhe kjo i ka krijuar bindjen se tokën bujqësore e kishte deklaruar me saktësi në deklaratën para fillimit të detyrës.

14.1.4 Në kohën e plotësimit të deklaratës “Vetting”, subjekti ka çmuar se mënyra më e saktë për ta deklaruar sipërfaqen e tokës bujqësore ishte sipas regjistrimit në ZVRPP-në Pogradec, në të cilën toka bujqësore me sip. 6326 m² ishte regjistruar në emrin e tij.

14.2 Në lidhje me mosdeklarimin e ndërtimit të babait, ndodhur në pronën e tij:

14.2.1 Subjekti shpjegoi se kjo depo, që babait të tij i shërbente për mbajtjen e druve, është ndërtuar para vitit 1990.

14.2.2 Depoja e druve me sip. trualli 324 m², fituar me kontratë shitblerjeje në datën 19.8.2002, nuk ndodhet në pronën e subjektit, por mbi një sipërfaqe trualli, pronë shtetërore në kohën e ndërtimit, e cila figuron e tillë edhe aktualisht.

14.2.3 Kjo sipërfaqe trualli mbi të cilën është ndërtuar depoja e druve i është dhënë babait të subjektit nga organet kompetente të kohës, në vitin 1973, së bashku me sipërfaqen e truallit mbi të cilën ka ngritur shtëpinë e banimit, të cilën e ka subjekti sot në pronësi.

14.2.4 Kur grupi i punës bëri regjistrimin fillestar të pronave në fshatin ***, ka pasqyruar në mënyrë të pasaktë sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme në mënyrë hartografike, por harta treguese pasqyron gjithë sipërfaqen prej 555 m², që babait të subjektit i kanë dhënë që në vitin 1973 organet kompetente të kohës.

Rrjedhimisht, nga zbritja e sipërfaqeve ($555 - 324 = 231 \text{ m}^2$), depoja e ndërtuar ndodhet pikërisht mbi sipërfaqen diferencë të truallit prej 231 m^2 në veri të truallit të subjektit prej 324 m^2 , blerë me kontratë shitblerjeje nga prindërit në datën 19.8.2002.

14.2.5 Kjo pasaktësi në hartën treguese të pasurisë së paluajtshme është korrigjuar pas aplikimit të subjektit për korrigjimin e gabimit të kryer në hartën treguese të pasurisë së paluajtshme me nr. ***.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

15. Trupi gjykues analizoi shpjegimet e mësipërme dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe, bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se:

15.1 Subjekti nuk ka kryer mosdeklarim të sipërfaqes tokë arë, pasi ajo është deklaruar e gjitha sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi, si burim i origjinës së krijimit.

15.2 Ka mospërputhje midis deklarimit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, me deklaratën "Vetting", lidhur me pjesën takuese të subjektit në këtë sipërfaqe tokë arë.

15.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, ka bërë korrigjimin e gabimit në hartën treguese të pasurisë së paluajtshme dhe ndarjen e pasurisë nr. *** në dy pasuri. Në hartën e korrigjuar të pasurisë së paluajtshme depoja e druve, e ndërtuar nga babai i subjektit, rezulton se nuk ndodhet në sipërfaqe truall prej 324 m^2 , në pronësi të subjektit, por në veri të pronës së subjektit.

15.4 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, për sa Komisioni kishte konstatuar në rezultatet e hetimit në lidhje me mospërputhjen e deklarimeve për pasurinë arë, përfutur në datën 19.8.2002, si dhe mosdeklarim të ndërtimit të babait, ndodhur në pronën e subjektit.

Në lidhje me ekzistencën e dy kontratave të shitblerjeje të datës 19.8.2002

16. Faktet nga hetimi administrativ

16.1 Kontrata e shitblerjes datë 19.8.2002, e dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, referon se subjekti ka blerë shtëpi banimi me sip. 127 m^2 , truall me sip. 324 m^2 , si dhe tokë bujqësore me sip. 6326 m^2 , në ***, Pogradec, të gjitha pasuritë së bashku në vlerën 100.000 lekë.

16.2 Gjatë hetimit administrativ, për pasuritë e mësipërme, nga ZVRPP-ja Pogradec u dërgua kontrata e shitblerjes, datë 19.8.2002, në të cilën këto pasuri janë blerë nga subjekti i rivlerësimit me vlera të veçanta për secilën pasuri, në total në shumën 145.000 lekë.

16.3 Të dyja kontratat janë hartuar përpara noteres B.S. midis të njëjtave palë dhe në të njëjtën datë, 19.8.2002, por me përmbajtje të ndryshme për sa i përket çmimit të blerjes.

16.4 Komisioni, gjatë të hetimit administrativ, në kushtet kur ka administruar dy kontrata të hartuara para të njëjtës notere, me të njëjtin numër repertori dhe koleksioni, me përmbajtje të ndryshme lidhur vlerën për të saktësuar situatën dhe për të arritur në një rezultat hetimi sa më të drejtë dhe të gjithanshëm, si dhe për të vendosur se cila nga kontratat ishte varianti i saktë që do të merrej në konsideratë, në analizën financiare i kërkoi shpjegime noteres B.S. dhe subjektit të rivlerësimit, për sa kishte rezultuar nga hetimi administrativ.

16.5 Me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2019, notere B.S., shpjegoi se pas verifikimit prej saj të kontratave, kontrata për të cilën palët kanë shprehur vullnetin e tyre të përbashkët, e ndodhur në arkiv, është kontrata e shitblerjes me vlerë transaksioni 100.000 lekë, ndërsa varianti tjetër i kontratës së shitblerjes, me vlera të specifikuar të cilat në total japin vlerën 145.000 lekë, është një gabim material njerëzor i saj në hartimin e përmbajtjes së kontratës dhe nuk është varianti për të cilën palët kanë rënë dakord.

16.6 Subjekti, lidhur me ekzistencën e dy kontratave të shitblerjes të datës 19.8.2002, me çmime të ndryshme, shpjegoi se nuk ka qenë në dijeni se ekzistonte edhe një variant tjetër i kontratës së

shitblerjes me nr. ***, datë 18.8.2002, i hartuar nga e njëjta notere B.S., midis të njëjtave palë, me të njëjtën datë, me të njëjtin numër rep. dhe kol. me të vetmin ndryshim në çmimin e blerjes së këtyre pasurive të paluajtshme nga 100.000 në 145.000 lekë.

16.7 Gjithashtu, nga hetimi administrativ Komisioni konstatoi se shitja e tokës bujqësore nga prindërit për subjektin e rivlerësimit ishte bërë nga babai dhe nga nëna pa nënshkrimin e motrës së subjektit, znj. M.I.

16.8 Për sa më sipër bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për mospërputhjet mbi çmimin e deklaruar në dy kontrata të ndryshme shitblerjeje për të njëjtën pasuri, dhe shitjen e tokave arë, pa shprehjen e vullnetit të motrës së subjektit, znj. M.I., si bashkëpronare e tokës bujqësore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës:

17. Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e sjella në Komision subjekti i rivlerësimit shpjegoi sa më poshtë:

17.1 Lidhur me ekzistencën e dy kontratave të shitblerjejes të datës 19.8.2002, sqaroi se nuk ka qenë në dijeni të faktit se ekziston edhe një variant tjetër i kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 18.8.2002, i hartuar nga e njëjta notere B.S., dhe se ky variant kontrate nuk është lexuar nga noteria para nënshkrimit si detyrim ligjor i saj (për t'u bërë të ditur palëve kontraktore përmbajtjen e aktit të hartuar prej saj), dhe palët kontraktore nuk kanë nënshkruar me vetëdije këtë variant kontrate, dhe nuk kanë në dispozicion nga noteria një kopje të kontratës.

17.2 Kopja e kontratës e cila është vënë në dispozicion të palëve nga noteria në kohën e nënshkrimit është varanti i kontratës ku pasuritë janë disponuar në shumën 100.000 lekë, dhe ky është varanti në të cilin palët kontraktore kanë shprehur vullnetin e përbashkët para noteres për ta nënshkruar.

17.3 Pasuritë e disponuara në këtë kontratë shitblerjeje janë deklaruar nga subjekti sipas dokumentit që dispononte me vlerë 100.000 lekë. Palët kontraktore nuk kanë pasur asnjë arsye të lidhin një kontratë tjetër me të njëjtën datë, me të njëjtin numër rep. dhe kol., për të njëjtin objekt me vlerë transaksioni 45.000 lekë më të lartë dhe kjo është vetëm një gabim i noteres B.S.

17.4 Lidhur me shitjen e tokës bujqësore në ***/Pogradec të panënshkruar nga motra e subjektit, znj. M.I., subjekti sqaroi se e motra ka qenë bashkëpronare në këtë pasuri të paluajtshme, si anëtare e familjes bujqësore, por në kohën e nënshkrimit të kontratës motra ka qenë e martuar dhe emigrante në Itali, dhe nuk e ka shprehur vullnetin para noterit për ta nënshkruar këtë kontratë shitblerjeje në pamundësi objektive për të ardhur dhe për ta nënshkruar këtë kontratë, në Shqipëri.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

18. Trupi gjykues, sipas konfirmimit të subjektit dhe të noteres, vlerëson se kontrata e lidhur dhe e ekzekutuar mes palëve është ajo sipas të cilës pasuritë e disponuara janë shitur midis palëve përkundrejt vlerës 100.000 lekë.

18.1 Komisioni vlerëson se në analizën financiare vlera 100.000 lekë do të llogaritet si shpenzim i subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurisë, shtëpi banimi me sip. 127 m² dhe truall 324 m², si dhe tokë me sip. 6326 m², në fshatin ***, Pogradec.

18.2 Komisioni, për sa i përket shitjes së tokës bujqësore në ***, Pogradec, të panënshkruar nga znj. M.I., arsyeton se ajo është bashkëpronare në këtë pasuri të paluajtshme referuar ligjit nr. 7501/1991 "Për tokën", sipas të cilit anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma të ndryshme të cilët ishin në përbërjen familjare të familjes bujqësore para datës 19.7.1991 përfitonin nga ky ligj.

18.3 Kjo pasuri nuk ishte pjesëtuar sipas rregullave të Kodit Civil, shtuar nga neni 4, i ligjit nr. 42/2017, sipas pikës 2/1, 2 të të cilit : "Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo

familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të këtij kodi për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti”.

18.4 Në këtë kuptim, motra e subjektit të rivlerësimit është në cilësinë e bashkëpronares me pjesë takuese ideale të ¼. Në këto kushte subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të “burimit” në momentin e krijimit të kësaj pasurie.

18.5 Trupi gjykues arsyeton se kjo pasaktësi në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk përbën arsye të mjaftueshme për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

II. Tokë bujqësore me sipërfaqe 3.464 m², ndodhur në fshatin ***, Pogradec, e përfutur në vitin 1992, në bashkëpronësi me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore. Burimi i krijimit: përfutur në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”. Në dokumentin që disponohet nga subjekti nuk përcaktohet vlera e kësaj sipërfaqeje toke. Pjesa takuese: 25 %.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës, aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr. *** regjistrimi, sipas së cilit familjes së B.L.I., nga fshati ***, Pogradec, i jepet në pronësi gjithsej tokë arë me sip. 8730 m² dhe pemëtore me sip. 1060 m², në total sip. 9.790 m².

Perputhet deklarimi i subjektit me faktet e konstatuara nga hetimi administrativ në lidhje me këtë pasuri.

III. Likuiditete

19. Gjatë hetimit administrativ është kryer një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur bazuar në gjendjet e likuiditeteve, të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare.

Ne tabelen e mëposhtme paraqiten llogaritë bankare të subjektit ndër vite

Gjendja e llogarive bankare	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Veting
TOTAL RFZ	39,027	417,171	502,092	453,527	459,886	485,005	512,630	539,655	556,039	2	0	0	0
RFZ Sokol 420760-ALL-3829000000-01-024	39,027	17,171	102,092	19,878	507	199	2,953	5,072	479	2	0	0	
RFZ Sokol 420760-ALL-3849000000-01-088		400,000	400,000	433,649	459,379	484,806	509,677	534,583	555,560	0	0	0	
TOTAL BKT	0	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000	470,016	1,878,682	2,130,060	2,681,516	0
BKT		300,000	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000	441,424	0			
BKT										1,725,834	1,725,834	1,781,434	1,781,434
BKT									28,316	152,848	302,176	682,022	536,342
BKT, bashkeshortja Eriselda Shahaj							0	0	277	0	102,050	218,060	181,423
TOTAL UNION BANK	0	0	0	0	0	400,000	977,438	950,910	1,552,179	1,476,795	1,568,827	1,568,827	
Union Bank nr.420311653060115							51,518	74	120,143	0			
Union Bank						400,000	425,920	450,836	476,804	502,123			
Union Bank									400,000	419,440			
Union Bank							500,000	500,000	555,232	555,232			
Union Bank											1,568,827	1,568,827	1,568,827
TOTAL TIRANA BANK	0	0	0	0	6,116	10,072	11,928	11	12	12	0	0	
Tirana Bank bsh					6,116	10,072	11,928	11	12	12	0	0	
SOCIETE GENERALE								600,000	600,000	600,000	1,168,788	1,168,788	
Sokol Ibi								600,000	600,000	600,000	1,168,788	1,168,788	1,188,686
BANKA CREDINS													
Sokol Ibi, llog. Page					95,920	131,920	920						
TOTAL CASH	0	0	50,000	50,000	400,000	500,000	600,000	400,000	600,000	250,000	100,000	70,000	70,000
TOTAL LIKUIDITETE	39,027	717,171	852,092	803,527	1,261,922	1,826,997	2,402,916	2,790,576	3,778,246	4,205,491	4,967,675	5,489,131	0
Shtesa /paksime	39,027	678,144	134,921	-48,565	458,395	565,075	575,919	387,661	987,670	427,245	762,185	521,456	

19.5 Në deklaratën “Vetting” si burim të ardhurash për krijimin e depozitave bankare subjekti ka deklaruar depozitat bankare nga shtatori i vitit 2006 (gjithsej vlera 700.000 lekë), krijuar nga të ardhurat si anëtar i familjes bujqësore, paga në komunën ***, paga në Bashkinë Pogradec, dhe bursa si student në Shkollën e Magjistraturës.

Gjendja e llogarive bankare	2005	2006
TOTAL Raiffeisen Bank	39,027	417,171
Raiffeisen Bank, ***	39,027	17,171
Raiffeisen Bank, ***		400,000
TOTAL BKT	0	300,000
BKT		300,000
TOTAL cash	0	0
Total likuiditeteve cash edhe në bankë	39,027	717,171
Shtesa /pakësime	39,027	678,144

19.6 Subjektit të rivlerësimit, në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera dhe për të provuar të kundërtën lidhur me pamundësitë financiare për krijimin e depozitave para fillimit të detyrës për hapjen e depozitave bankare në “Raiffeisen Bank” dhe në “BKT” (400.000 lekë dhe 300.000 lekë) gjithsej shuma 700.000 lekë në shtator të vitit 2006, para fillimit të detyrës duke rezultuar me bilanc negativ prej – 483.074 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

20. Pas kalimit të barrës së provës, me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision, subjekti i rivlerësimit shpjegoi, sa më poshtë:

“ - Pas ndarjes nga familja bujqësore e babait tim në vitin 1999, nga të ardhurat e përbashkëta të familjes bujqësore nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral prindërit më kanë ndarë dhe dhënë shumën prej 500.000 lekësh si vlerë për kontributin tim në shtimin e pasurisë së familjes bujqësore deri në kohën e ndarjes nga trangu familjar në vitin 1999, shumë e cila duhet të llogaritet si e ardhur në tabelën e analizës financiare në kolonën 1999 – 2002

- Duhet llogaritur si e ardhur edhe shuma prej 280.000 mijë lekësh që kam përfutuar nga aktiviteti bujqësor i mbledhjes dhe shitjes së bimëve medicinale. Në periudhën kohore muajt korrik, gusht dhe deri në 15 shtator, përgjatë viteve 2000, 2001, 2002, 2003 dhe 2004, kam mbledhur bimë medicinale (lule cjan), të cilat i shisja te subjekti tregtar “***” sh.p.k., sipas deklaratës noteriale të I.S.Xh., datë 15.7.2019.

- Për vitin 2003 konstatoj se më keni llogaritur shpenzime jetike në shumën 93.964 lekë. Unë në këtë vit shpenzimet jetike i mbuloja me produktet bujqësore dhe blegtorale që siguroja nga puna si i vetëpunësuar në bujqësi, sikurse në vitet paraardhëse (subjekti i rivlerësimit pretendon se megjithëse ka qene i punësuar në komunën ***, shpenzimet jetike janë mbuluar me produktet bujqësore dhe blegtorale).

- Në vitin 2004 konstatoj se më keni llogaritur shpenzime jetike në masën 62.643 lekë. Unë në këtë vit shpenzimet jetike i mbuloja me produktet bujqësore dhe blegtorale që siguroja nga puna në bujqësi, deri në kohën që kam filluar Shkollën e Magjistraturës.

- Për vitin 2004 më keni llogaritur shpenzime arredimi në shumën 67.500 lekë. Unë në këtë vit nuk kam kryer asnjë shpenzim arredimi.

- Në vitin 2005 më janë llogaritur si shpenzime arredimi shuma prej 180.000 lekësh. Në këtë vit nuk kam kryer shpenzime arredimi pasi shtëpia ku banoja në Tiranë, sikurse sqarova më sipër, ka qenë e arreduar. Si shpenzime për këtë vit duhet të më llogariten vetëm shpenzimet e jetesës dhe të qirasë gjatë kohës së Shkollës së Magjistraturës për këtë vit, në shumën 202.500 lekë”.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

21. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ibi, dhe bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se:

21.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues, si më poshtë:

- të ardhura nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral;
- të ardhurat nga mbledhja dhe tregtimi i bimëve medicinale (lule ciani).

21.2 Deklaratat noteriale të depozituara nga subjekti kanë vlerë të kufizuar ligjore pasi janë bërë gjatë hetimit administrativ, prandaj këto të ardhura nuk do të llogariten në analizën financiare.

21.3 Komisioni, në analizën financiare ka llogaritur shpenzime jetike në periudhën që subjekti ka qenë i punësuar në komunën ***, Bashkinë Pogradec dhe në muajt e pushimeve të Shkollës së Magjistraturës, pasi nuk provohet sa deklaroi subjekti i rivlerësimit se nuk ka kryer shpenzime jetike.

21.4 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga subjekti, pas ndarjes nga familja bujqësore, në kohën e ndarjes nga trugu në vitin 1999, në shumën 500.000 lekë, trupi gjykues analizoi deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura si pjesë e kontributit të tij në familjen bujqësore, në shumën prej 500.000 lekësh.

21.5 Trupi gjykues, në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i ka njohur vlerën e provës deklarates së pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2006, si e dhënë që vërteton pretendimet e subjektit në proces, dhe duke e çmuar atë me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli.

21.6 Trupi gjykues vlerëson se në analizë të provave në tërësi me rrethanat e çështjes, dhe bazuar në sa subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2006, subjekti arriti të provojë të ardhurat në shumën prej 500.000 lekësh, si vlerë për kontributin në kohën e ndarjes nga trugu familjar në vitin 1999.

21.7 Analiza përfundimtare financiare për subjektin në periudhën 1999 – shtator 2006, si më poshtë:

Analiza financiare 1999 - 2006	Analiza përfundimtare
Shtëpi banimi me sip. 127 m ² dhe truall blerë në vitin 2002	100,000
Shtuar likuiditetet në bankë	717,171
Total likuiditet	717,171
DETYRIME	
PASURI NETO	817,171
Të ardhura	1,742,983
Të ardhura subjekti	1,742,983
Perfitim nga familja bujqësore	500,000
SHPENZIME	886,071
Shpenzime magjistratura	405,000
Shpenzime jetike	481,071
Rezultati financiar	39,741

21.8 Trupi gjykues arriti në përfundimin se para fillimit të detyrës për periudhën 1999 – 2006 subjekti ka provuar mundësinë të krijojë gjendje në llogaritë bankare. Subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare para fillimit të detyrës.

22. Autoveturë e markës “Mercedes - Benz”, marrë në përdorim nga shtetasi B.I., me kontratë huapërdorjeje e datës 27.11.2014. Vlera e blerjes: 400.000 lekë.

22.1 Sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., datë 22.10.2008, babai i subjektit, shtetasi B.L.I., bleu automjetin tip “Mecedes Benz” në vlerën 400.000 lekë.

22.2 Nga kontrata e huapërdorjes nr. ***, datë 27.11.2014, rezulton se z. B.I., i jepet hua një autoveturë e markës “Mecedes Benz”, me nr. shasie ***, me targa ***, ngjyrë vishnje, për një periudhë 1-vjeçare.

22.3 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, me shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2019, informon se z. B.L.I., nuk është pajisur me leje drejtimi për drejtimin e mjeteve rrugore.

22.4 Subjektit, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa duket se blerja e këtij mjeti nga babai i tij ka pasur leje drejtimi, ka pasur si qëllim vetëm përdorimin e këtij mjeti nga subjekti, duke ngritur dyshime mbi pronarin e vërtetë të këtij mjeti.

23. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

23.1 Është e vërtetë që babai i subjektit, në kohën që e ka blerë këtë automjet nuk ka pasur leje drejtimi. Arsyeja që babai i subjektit e ka blerë këtë mjet në vitin 2008 është që t’i shërbente nevojave të tij dhe të nënës së subjektit, të cilët, për shkak të moshës së thyer dhe të sëmundjeve, e kanë të domosdoshme kontrollin periodik të mjeku i familjes dhe të specialisti përkatës në Spitalin Rajonal të Pogradecit.

23.2 Qendra shëndetësore ku ndodhet mjeku i familjes ndodhet rreth 2 km larg banesës ku banojnë prindërit e subjektit në fshatin ***, ndërsa Spitali Rajonal i Pogradecit ndodhet disa km larg fshatit të subjektit. Në të tilla rrethana, babai i subjektit e ka parë të nevojshme blerjen e një automjeti për t’i shërbyer atij dhe nënës së subjektit për të shkuar te mjeku i familjes, si dhe në Spitalin Rajonal Pogradec, për të kryer kontrollet periodike të shëndetit nga sëmundjet që ata vuajnë.

23.3 Meqenëse babai i subjektit nuk ka pasur leje drejtimi, çdo herë që prindërit e subjektit kishin nevojë për të shkuar te mjeku i familjes apo në spital për shkak të nevojave shëndetësore, automjetin e ka drejtuar subjekti. Në të tilla rrethana subjekti deklaroi se nuk është i vërtetë konstatimi se blerja e këtij automjeti nga babai i tij ka pasur si qëllim vetëm përdorimin e këtij mjeti nga ana e tij, por që ky automjet t’ju shërbejë nevojave shëndetësore dhe moshës së prindërve.

23.4 Prindërit e subjektit kanë pasur mundësi të blejnë këtë automjet me kursimet dhe të ardhurat e viteve të mëparshme deri në kohën e blerjes së këtij automjeti, dhe po kështu edhe subjekti ka pasur mundësi të blejë automjet me mundësitë e tij financiare në këtë kohë, dhe nuk ka arsye për të ngritur dyshime mbi pronarin e vërtetë të këtij mjeti.

23.5 Në mbështetje të këtyre shpjegimeve subjekti depozitoi edhe dy shkresa të datës 9.6.2019 të titulluar “raporte - mjekësore” të mjekut të familjes pranë Qendrës Shëndetësore ***, si dhe vërtetimin e lëshuar nga specialistja kardiologë – patologë e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

24. Trupi gjykues, pasi analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se

24.1 z. B.I., dhe znj. H.I., kreu analizen financiare nga ku rezultoi se prindërit e subjektit kanë pasur aftësi financiare për blerjen e automjetit.

24.2 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti së bashku me provat e tjera në tërësi me rrethanat e çështjes, ishte bindës në shpjegimin e tij për arsyen e blerjes së këtij automjeti nga babai dhe arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit.

Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë

25. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ibi, ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, dhe pasaktësia e konstatuar për “burimin” në momentin e krijimit të pasurisë së deklaruar nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë dhe nuk cenon figurën e gjyqtarit, si dhe besimin e publikut të drejtësisë. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

26. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017 dhe deklasifikuar me vendim të KDZH-së me nr. *** prot., datë 7.2.2019, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Ibi.

27. Nga hetimi administrativ nuk rezultuan elemente që të ngrenë dyshime për ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

28. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ibi, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

29. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI, nenet 40 e vijues të tij, si dhe mbi bazën e kriterëve përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku në përfundim ky organ ka lëshuar një raport të hollësishëm.

30. Komisioni, si organi kompetent sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë” për rivlerësimin profesional të subjekteve të rivlerësimit, vlerësoi gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bazuar në këtë ligj, si dhe në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, paraqet relacionin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, si më poshtë:

31. ANALIZA E GJETJEVE

Aftësitë profesionale dhe njohuritë ligjore

Gjyqtari Sokol Ibi ka njohuri në drejtëm të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai ka shqyrtuar mosmarrëveshje që kërkojnë njohuri në të drejtën administrative. Në 1 rast njohuritë e tij për sa i përket interpretimit të ligjit procedural civil që lidhet me provat dhe formimin e ndërgjyqësisë nuk janë konfirmuar nga gjykata e apelit. Gjyqtari njih parimet e përgjithshme procedurale gjatë gjykimit dhe në funksion të zgjidhjes së çështjes identifikon fushën e zbatimit të normës ligjore përkatëse. Në tri dokumentet

ligjore nuk ka të dhëna nëse janë ankimuar, ndërsa në pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar tre prej tyre ku në dy raste vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe nuk ka rekurs në Gjykatën e Lart, në një rast vendimi është cenuar nga Gjykata e Apelit.

Arsyetimi ligjor

Gjyqtari Sokol Ibi në tre dokumentet ligjor të prezantuara prej tij dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short tregon se ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara janë të kuptueshme, përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe të ligjit për të treguar lidhjen midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në një rast mungon arsyetimi që lidhet me zgjidhjen e pasojave juridike të pavlefshmërisë së aktit administrativ. Në vendimet përfundimtare gjyqtari pasqyron dhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës lidhur me pretendimet e palëve ndërgjyqëse.

Aftësitë organizative dhe aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Gjyqtari Sokol Ibi ka deklaruar se në periudhën e rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Sokol Ibi ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj deri në 7 muaj. Ligji organik, material dhe procedural nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” nuk ka përcaktuar afat të prerë për përfundimin e gjykimit të çështjes, por në pikën 1, të nenit 25, citohet: “...për zhvillimin e gjykimit sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme”, janë përcaktuar një sërë afatesh ditore procedurale që nga shortimi i çështjes deri në dorëzimin e vendimit të arsyetuar në kryesekretarinë e gjykatës. Ndërsa në interpretim të shkronjës “c”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të gjyqtarëve të përcaktuar me vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, të KLD-së, në aspektin kohor, gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e shkallës së parë duhet të gjykohen jo më tej se 1 muaj. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se gjyqtari Sokol Ibi është eficient në kryerjen e veprimtarisë gjyqësore.

Gjyqtari Sokol Ibi i ka kushtuar rëndësi kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke arsyetuar në dosjet e vëzhguara të gjitha vendimet brenda afatit shtatë ditor të parashikuar në pikën 3, të nenit 42, të ligjit nr. 49/2012.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Gjyqtari Sokol Ibi ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Është konstatuar se ai kryen me korrektësi dhe në kohë veprimet përgatitore të përcaktuara në nenin 25, të ligjit nr. 49/2012, duke vlerësuar nëse padia ka të meta, i njofton të paditurit aktet dhe i cakton afat atij për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, aktet e paraqitura prej të paditurit ia njofton paditësit në respektim të afateve të parashikuara në dispozitën e sipërcituar, por në dy raste nuk ka vendim në aspektin formal për caktimin e seancës së parë përgatitore, por veprimet janë kryer brenda afatit. Në dosjet e vëzhguara planifikimi i seancës së parë gjyqësore është brenda afatit 15 ditor të parashikuar në nenin 27/1, të ligjit nr. 49/2012, ndërsa disponimi për caktimin e seancës gjyqësore është në përputhje me detyrimet që parashikon neni 27/2 i po këtij ligji.

Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në to.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

Nga verifikimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar të dhëna negative lidhur me komunikimin verbal dhe shkresor me kolegët, administratën, palët ndërgjyqëse dhe të tretët, brenda dhe jashtë procesit gjyqësor.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ibi, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë gjyqtari dhe nga pesë dosjet e vëzhguara është evidentuar një rast i konfliktit të interesit ku bashkëshortja e gjyqtarit ka qenë e punësuar në administratën pranë palës paditur, gjyqtari i ka paraqitur dorëheqjen kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit i cili nuk e ka pranuar dorëheqjen me arsyetimin se i paditur është Këshilli i komunës *** dhe jo komuna *** ku është punësuar bashkëshortja e gjyqtarit.

Në tre dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit që lidhen me respektimin e rregullave procedurale dhe me standardin e gjykatës së paanshme.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor dhe në shkresat drejtuar palëve të treta është konstatuar se gjyqtari Sokol Ibi komunikon me etikë me pjesëmarrësit në proces dhe jashtë tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore.

Aftësia për të bashkëpunuar

Në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Sokol Ibi për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvoja profesionale me ta.

Gatishmëria për t'u angazhuar

Gjyqtari Sokol Ibi i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Të dhënat e Shkollës së Magjistraturës të dokumentuara me vërtetimin nr. *** prot., datë 21.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës provojnë se gjyqtari për përdhën tre vjeçare të rivlerësimit ka qenë pjesëmarrës në 29 seminare trajnimi me 41 ditë në 3 vjet ose rreth 14 ditë në vit. Për rrjedhim, subjekti ka plotësuar standardin minimal të pjesëmarrjes në formimin vazhdues prej 24 ditësh në 3 vjet, sipas pikës 5, të nenit 76, të ligjit 96/2016. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ.

32. Subjekti i rivlerësimit, ka shpjeguar, si më vijon:

Lidhur me zgjatjen tej afatit kohor një mujor për tre çështjet e përzgjedhura subjekti ka sqaruar se arsyet e mospërfundimit brenda afatit kohor të këtyre gjykimeve në këto tre çështje janë:

Së pari: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka funksionuar me vetëm dy gjyqtarë që nga krijimi i saj e deri me sot, nga 4 gjyqtarë që është numri i përcaktuar me Dekret të Presidentit të Republikës për këtë gjykatë, dhe se gjithë fluksi i punës në këtë gjykatë në kohën që janë gjykuar këto çështje është përballuar me vetëm dy gjyqtare, ku subjektit i është dashur të kryejë edhe punën administrative si kryetar i kësaj gjykate.

Së dyti: Ngarkesa e punës, në periudhën kohore që janë gjykuar këto çështje, ka qenë tepër e lartë dhe në sallën e vetme të gjykimit që kishte në dispozicion kjo gjykate zhvilloheshin mesatarisht 15-20 procese gjyqësore në ditë.

Së treti: Gjykata Administrative Shkallës së Parë Korçë ka pasur në dispozicion për të zhvilluar seancat gjyqësore vetëm një sallë gjykimi. Duke marrë parasysh edhe detyrimin ligjor që të gjitha proceset gjyqësore duhet të zhvilloheshin në sallën e gjykimit ku të regjistroheshin në sistemin audio, për këto shkaqe planifikimet e seancave të para përgatitore janë bërë në datat që salla e gjykimit ishte e lirë. Më tej, konkretisht ai ka ndaluar te vendimi nr. ***, date 13.7.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ku ka sqaruar se në zgjatjen e procesit gjyqësor përtej afati kohor 1 mujor është marrë parasysh edhe kompleksiteti i çështjes dhe sjellja e palëve në gjykim, kërkesat procedurale të bëra nga palët, të cilat kanë ndikuar në zgjatjen e procesit gjyqësor.

33. Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

34. Subjekti paraqiti para trupit gjykues arsyet për mos respektimin ne disa raste te afatit prej 30 ditësh sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 179, të Kushtetutës; të shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 160, dhe shkronjës “a”, pikës 1, të nenit 173, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

35. Trupi gjykues vlereson se subjekti arriti te shpjegoje arsyet e për mos respektimin ne disa raste te afatit prej 30 ditësh si dhe nuk konstatoi që subjekti të këtë kryer shkelje të tjera si parregullësi në veprimet procedurale, mosnxjerrje të vendimeve të ndërmjetme, përdorim të referencave të gabuara ligjore, apo të dhëna të tjera që do të tregonin se subjekti ka një model pune dhe gjykim të dobët, mosrespektim të së drejtave të palëve dhe nuk është efektiv, te tilla qe do te ndikonin ne vleresimin e pergjithshem te aftesive profesionale te subjektit te rivlersimit.

Konkluzioni për vlerësimin e aftësisë profesionale

36. Trupi gjykues, bazuar në: (i) konstatimet e mësipërme dhe në argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; dhe (ii) gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor bazuar në kreun II, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale

37. Bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, Komisioni i ka marrë në shqyrtim denoncimet e ardhura si më poshtë vijon:

1. J.A.N.;
2. Shoqëria “****”;
3. “****” sh.p.k.;
4. R.Sh.K.;
5. V.D.A.;
6. A.Q.Xh.;
7. M.P.;
8. Denoncim anonim.

38. Komisioni analizoi keto denoncime e i kerkoi shpjegime subjektit si me poshte vijon:

38.1 Denoncimi nr. 1

Denoncim i shtetasit J.A.N., regjistruar me nr. *** prot., datë 11.7.2018.

Objekti i denoncimit: Denoncim ndaj gjyqtarit Sokol Ibi, për vendimmarrje të padrejtë, të pabazuar në ligj dhe prova lidhur me një padi të paraqitur nga denoncuesi me objekt shfuqizimin e aktit administrativ, vendimi nr. ***, datë 25.10.2017, për dënimin e denoncuesit në masën 300.000 lekë për kryerjen e kundërvajtjes administrative parashikuar nga germa “d”, e pikës 1, të nenit 20, të ligjit nr. 9636/2006. Denoncuesi pretendon se gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij “bar-kafe” në qytetin Bilisht, inspektorë të ISHSH-së Korçë kanë kryer inspektim në ambientet e tij, ku në përfundim

kanë gjobitur denoncuesin me gjobë për duhanpirje, pa pasur asnjë provë. Gjithashtu, subjekti pretendon se vendimi nuk është i arsyetuar, si dhe sipas këtij vendimi i është mohuar e drejta e ankimit. Subjekti ka bashkëlidhur një kopje të procesverbalit të inspektimit me nr. serie ***, si dhe të vendimit nr. ***, datë 6.6.2018.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka dhënë këto shpjegime, ndër të tjera, se në cilësinë e gjyqtarit në këtë çështje ka vlerësuar se paditësi me mosveprimet e tij të kundërligjshme ka kryer kundërvajtjen administrative të lejimit të duhanpirjes në ambientet e brendshme të lokalit ku ai ushtron aktivitet tregtar, kundërvajtje administrative, kjo e parashikuar nga pika “d”, e nenit 15, dhe 15/2 të ligjit nr. 9636/2006. Paditësi si subjekt i tatueshëm, person fizik tregtar, që ushtronte aktivitet në këtë lokal ka qenë përgjegjës për këtë shkelje administrative, pasi ka lejuar pirjen e duhanit në ambientet e brendshme të lokalit ku ai ushtronte aktivitet tregtar. Në të tilla rrethana në baze të pikës “i”, të nenit 20/1, paditësi është dënuar me gjobë në masën 300.000 lekë nga inspektorët e ISSH-së Korçë për kryerjen e kësaj kundërvajtje administrative si subjekt i tatueshëm. Në vijim, ka sqaruar se ka arsyetuar vendimin, duke përcaktuar se cilat janë mosveprimet e kundërligjshme që ka kryer paditësi dhe që përbëjnë kundërvajtje administrative, duke cituar dispozitën ligjore që parashikon kundërvajtjen administrative, konkretisht pika “d”, e nenin 15, të ligjit nr. 9636/2006, dhe duke vlerësuar se vendimet, objekt kundërshtimi, janë në përputhje me këtë dispozitë ligjore të shkelur nga paditësi. Subjekti, në të tilla rrethana ka vlerësuar se ka shqyrtuar ligjshmërinë e veprimeve administrative të ISSH-së Korçë, si dhe të vendimit të Komisionit të Ankimit që ka lënë në fuqi vendimin e ISSH-së Korçë, bazuar në nenin 15 dhe 20 të ligjit nr. 9636/2006.

Lidhur me konstatimin se vendimi i gjykatës nuk është i arsyetuar, subjekti ka sqaruar se vendimi nr. ***, datë 6.6.2018, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë është i arsyetuar dhe përmban të gjithë elementet e një vendimi gjyqësor të parashikuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile, pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke e sqaruar në detaje lidhur me vendimin konkret. Subjekti ka sqaruar se ka kryer një proces të rregullt ligjor dhe nuk ka shkelur dispozitat ligjore.

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e Komisionit. Komisioni vlerëson se procesverbali i referuar në vendim dhe cituar në shpjegime, i nënshkruar nga punonjësit e ISSH-së Korçë, ka mjaftuar të provojë se në ambientet e denoncuesit po lejohej duhanpirja, dhe për rrjedhojë të bindë gjykatën se denoncuesi ka kryer kundërvajtje administrative. Subjekti duhet të kishte shqyrtuar mbi pretendimin e denoncuesit se në lokalit e tij kanë qenë të vendosura shenja dalluese, si tabelat antiduhan dhe se në tavolina nuk kanë qenë të vendosura tavla, si masa këto në kuadër të përcaktimit të përgjegjësisë së denoncuesit si pronar i lokalit, sipas nenit 16, të ligjit nr. 9636/2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, me qëllim që të vlerësonte mbi përgjegjësinë e denoncuesit dhe vleftësimin e veprimeve të administratës publike. Në këtë kuadër, Komisioni vlerëson se arsyetimi i vendimit nga subjekti duhet të ishte më i plotë.

38.2 Denoncimi nr. 2

Denoncim i shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator E.B., regjistruar me nr. *** prot., datë 12.12.2018.

Ky denoncim i është drejtuar edhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë në formën e një kërkesë për inspektim fillimi procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit. Në vijim, denoncuesi nëpërmjet praktikës së regjistruar me nr. ***, datë 23.4.2019, ka paraqitur sërish denoncimin me plotësimet e dokumentacionit mbështetës.

Objekti i denoncimit: Denoncuesi është ankuar për vendim të padrejtë të marrë nga subjekti i rivlerësimit me nr. ***, datë 15.10.2018, ku subjekti ka rrëzuar padinë e paraqitur kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë me objekt: detyrimin e Drejtorisë Rajonale të

Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë të shpërblejë dëmin e shkaktuar në vlerën 60.529.530 lekë, si pasojë e gabimit të saj në numrin e identifikimit të mjetit me targa *** dhe me leje qarkullimi nr. **, fitimin e munguar, si edhe pagesat për taksat e detyrime të tjera që rrjedhin për mjetin deri në fund të gjykimit, etj. Denoncuesi është ankuar se subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur për kërkimet e tij në padi lidhur me konfliktin administrativ me Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë, për lëshimin gabim të lejes së qarkullimit, si dhe pasojat ligjore që i kanë ardhur denoncuesit nga ky gabim i drejtorisë. Gjithashtu, denoncuesi është ankuar për zvarritje të procesit gjyqësor.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Procesi gjyqësor ka qenë kompleks dhe është kryer edhe një ekspertim në gjykim. Pala paditëse (denoncuese) ka parashtruar herë pas here kërkesa të ndryshme procedurale në proces, si për marrje provash të tjera, për kryerje ekspertimi, për saktësimin e objektit të padisë etj., kërkesa këto që kanë sjellë mospërfundimin e gjykimit vetëm me një seancë. Subjekti ka sqaruar se nuk është bërë shkaktar asnjëherë për zvarritjen e këtij procesi gjyqësor, por ka qenë sjellja e palëve ndërgjyqëse (kryesisht e palës paditëse denoncuese) shkaktare për zvarritjen e gjykimit të çështjes, si dhe kompleksiteti i çështjes.

38.3 Denoncimi nr. 3

Denoncim me nr. ** prot., datë 4.3.2019, i av. S.N., përfaqësues me prokurë i shoqërisë “**” sh.p.k.

Objekti i denoncimit: Denoncim për korrupsion i gjyqtarit Sokol Ibi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Në denoncimin e tij av. S.N., shprehet për vendim të padrejtë me nr. **, datë 4.2.2019, të marrë nga z. Sokol Ibi, i cili ka shkelur rëndë ligjin, duke pranuar padinë e paditësit J.F., kundër të paditurve Bashkia Korçë dhe “**” sh.p.k., për shfuqizimin e lejes së ndërtimit, dhënë në favor të kësaj shoqërie. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendimin nr. **, datë 4.2.2019, të subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pretendimi i palës së paditur në gjykim dhe i denoncuesit në rastin konkret, nuk është i bazuar në prova dhe në ligj. Pala paditëse në gjykim nuk e kundërshton lejen e ndërtimit të dhënë nga Bashkia Korçë, vetëm për faktin se nuk janë respektuar distancat në raport me pronat kufitare, por e kundërshton, së pari për faktin se pala e paditur, Bashkia Korçë, këtë leje ndërtimi e ka dhënë duke mos respektuar distancat objekt me objekt në raport me objektin në pronësi të palës paditëse. Në të tilla rrethana, pala paditëse legjitimohet në këtë kërkim në padi, pasi pretendon se nga mosrespektimi i distancave të objektit për të cilin është dhënë leja e ndërtimit me objektin në pronësi të palës paditëse, paditësi cenohet në të drejtën e tij të pronësisë për shkak të këtij akti administrativ të kundërligjshëm. Gjatë gjykimit rezultoi se leja e ndërtimit e dhënë nga pala e paditur, Bashkia Korçë, është dhënë në shkelje të kërkesave të ligjit dhe të akteve nënligjore, pasi nuk ka respektuar distancat objekt me objekt, si në anën veriore, ashtu edhe në anët jugore, perëndimore dhe lindore. Në të tilla rrethana, subjekti ka vlerësuar se nuk ka kryer shkelje të ligjit në dhënien e këtij vendimi, por përkundrazi ka zbatuar drejt ligjin në dhënien e këtij vendimi.

38.4 Denoncimi nr. 4

Denoncim i shtetases R.Sh.K., me nr. ** prot., datë 30.11.2017.

Objekti i denoncimit: Denoncim ndaj subjekteve të rivlerësimit, z. B.Sh., Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, si dhe z. Sokol Ibi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë për korrupsion, pasi këta subjekte kanë gjykuar disa çështje ku u është mohuar e drejta. Nëpërmjet denoncimit pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur procesin gjyqësor dhe nuk ka gjykuar drejtë lidhur me konfliktin me palë ndërgjyqëse dhe objekt: paditës B.H., i paditur Zyra e Gjendjes Civile e Qarkut Korçë (në mungesë), me objekt pavërtetësi dokumenti fletë regjistri nr. **, e viteve 1930

– 1945, për sa i përket trungut familjar të shtetasit A.Q., i biri i S., te rubrika e kryefamiljarit, duke u pasqyruar nga i gabuari A. (X.) Q., në A. (H.) Q., për të cilin subjekti ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, ndër të tjera, ka dhënë shpjegimin se pretendimet e palës paditëse për zvarritje të procesit gjyqësor janë pretendime të pabazuara. Gjykata nuk është bërë asnjëherë shkaktare për zvarritjen e këtij procesi gjyqësor. Shkak për zgjatjen e procesit gjyqësor ka qenë ngarkesa në punë e gjykatës në këtë periudhë kohore, pasja në dispozicion e një salle gjykimi dhe qenia në organikën e kësaj gjykate të vetëm dy gjyqtareve nga katër gjyqtarë, që ishin caktuar.

38.5 Denoncimi nr. 5

Denoncimi i shtetasës V.D.A., (përfaqësuese me prokurorë e shtetasit P.P.), me nr. *** prot., datë 15.12.2017, dhe plotësuar dokumentacioni me praktikën nr. *** prot., datë 17.4.2019.

Objekti i denoncimit: Denoncim ndaj gjyqtarit Sokol Ibi për dhënie vendimi të padrejtë ndaj shtetasit P.P., për të përfituar dëmshpërblim si trashëgimtar ligjor i të ndjerit I.P., vrarë në krye të detyrës në vitin 2013, si dhe për zvarritje të procesit.

Komisioni vlerësoi faktet, si dhe vendimin e gjykatës vënë në dispozicion nga denoncuesja, nga ku konstatohet se shtetasi P.P., ka paraqitur padi në gjykatë kundër Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komandës Mbështetëse pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me objekt detyrimin e palës së paditur për të dëmshpërblyer paditësin P.P., për dëmin e plotë pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga vrasja në krye të detyrës të shtetasit I.P., në shumën 4.032.917 lekë, si dhe pagimi i kamatëvonesave.

Subjekti i rivlerësimit, pasi ka vlerësuar pretendimet e palëve, ka caktuar një ekspert për vlerësimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, duke pranuar brenda objektit të kërkimit të paditësit për vlerën totale të dëmit, në shumën 4.032.917 lekë, si dhe kamatat e arrira deri në datën e kryerjes së aktit të ekspertimit, në vlerën 262.271 lekë. Pra, ndryshe nga çfarë pretendon denoncuesja, duket se subjekti e ka pranuar tërësisht pretendimin për dëmshpërblimin në shumën e kërkuar.

Nga vlerësimi i vendimit është vënë re se paditësi gjatë gjykimit ka pretenduar dëmshpërblim edhe ndaj shtetasës F.P., ku në përfundim subjekti i rivlerësimit ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë, me arsyetimin se kjo shtetase duhet ta kërkonte vetë dëmin apo, në pamundësi, të përfaqësohej me prokurorë në gjykim për shkak se askush nuk mund të kërkojë të drejtat e të tjerëve, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

Komisioni, në lidhje me pretendimin për zvarritje të gjykimit, konstatoi se kjo çështje në fillim është paraqitur në Gjykatën Administrative Tiranë, ku me vendimin nr. ***, datë 22.10.2015, është shpallur moskompetenca tokësore dhe çështja ka kaluar për shqyrtim në Gjykatën Administrative Korçë. Gjithashtu, gjatë gjykimit janë kryer edhe veprime procedurale të nevojshme si, saktësim objekti, thirrje eksperti, të cilat mund të kenë ndikuar në zgjatjen e shqyrtimit.

Subjekti, edhe pse nga Komisioni nuk i janë kërkuar shpjegime për këtë denoncim, ka dhënë këto shpjegime në lidhje vendimin:

Ai ka shpjeguar se vendimi i gjykatës është dhënë në bazën e dispozitave ligjore që rregullojnë institutin civil të shpërblimit të dëmit. Gjykata iu ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse në atë gjykim dhe, për rrjedhojë, kundërshton pretendimin e denoncueses se ky vendim gjyqësor është i padrejtë. Lidhur me pretendimin e denoncueses se ka pasur zvarritje të procesit gjyqësor, janë pretendime të pabazuara. Subjekti ka sqaruar se nuk është bërë asnjëherë shkaktar për zvarritjen e këtij procesi gjyqësor. Çështja ka qenë komplekse dhe gjatë gjykimit janë kryer një sërë veprimesh procedurale si, saktësim objekti i padisë, caktim eksperti, si dhe saktësim i emrit të palës së paditur nga pala paditëse. Në zgjatje të këtij procesi gjyqësor ka ndikuar edhe ngarkesa në punë e gjykatës në këtë periudhë kohore, pasja në dispozicion e një salle

gjykimi dhe qenia në organikën e kësaj gjykate të vetëm dy gjyqtareve nga katër gjyqtare që është caktuar të ishin. Këto janë shkaqe objektive që nuk varen nga gjyqtari i çështjes.

38.6 Denoncimi nr. 6

Denoncimi i shtetasit A.Q.Xh., me nr. *** prot., datë 5.4.2019, plotësuar me praktikën nr. ***, datë 30.4.2019. Objekti i denoncimit: Denoncim i gjyqtarit Sokol Ibi për shkelje të etikës profesionale, zvarritje në proces dhe njëanshmëri në gjykim.

Nga vlerësimi i fakteve dhe dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se denoncuesi ankohet për cenimin e interesave të tij të pronësisë nga vendimi i gjyqtarit, i cili ka vendosur në disfavor të tij, duke konstatuar pavlefshmërinë e veprimit administrativ datë 6.3.2018, dhe planrilevimit bashkëngjitur këtij akti, për shkak se denoncuesi, në cilësinë e të paditurit, nuk ka parapaguar tarifën përkatëse në ZVRPP-në Korçë për korrigjimin e hartës treguese të pasurisë së paluajtshme, tarifë e cila, bazuar në nenin 71, të ligjit nr. 33/2012, është e detyrueshme dhe për pasojë veprimet e ndërmarra nga ZVRPP-ja duhet të shpallen të pavlefshme. Duket se subjekti ka shqyrtuar kërkimet e palëve në padi, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në përfundim ka vendosur për zgjidhjen e konfliktit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në dhënien e vendimit për çështjen administrative, ku palë e paditur ka qenë edhe denoncuesi A. XH., subjekti ka sqaruar se ka zhvilluar një gjykim me paanësi, në respektim të plotë të etikës profesionale dhe brenda afateve të arsyeshme, duke marrë parasysh edhe kompleksitetin e çështjes. Më tej, subjekti ka sqaruar se i ka dhënë zgjidhje konfliktit midis palëve që paraqitej në gjykim me padinë e paditësit, dhe se këtë zgjidhje e ka dhënë referuar legjislacionin në fuqi. Pretendimet e ankuesit për paligjshmërinë e vendimit janë pretendime të pabazuara. Kjo çështje administrative është në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

38.7 Denoncimi nr. 7

Denoncim i shtetasit M.P., përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k., regjistruar me nr. *** prot., datë 3.5.2019, bashkëlidhur dokumentacioni mbështetës.

Objekti i denoncimit: Denoncim ndaj gjyqtarit Sokol Ibi, lidhur me dhënien e vendimit nr. ***, datë 4.3.2019, i cili është dhënë në disfavor të tij.

Nga vlerësimi i fakteve dhe dokumentacionit, duket se denoncuesi është ankuar ndaj vendimit të sipërcituar, ku është vendosur rrëzimi i padisë lidhur me kërkimin për një dëm jashtëkontraktor të shkaktuar denoncuesit, për shkak të anulimit të procedurës së prokurimit publik, me vendim të Bashkisë Korçë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Arsyeja e rrëzimit të padisë ka qenë sepse nuk u provuan në gjykim të gjithë elementët e marrëdhënies juridike të shkaktimit të dëmit të pretenduar se ia ka shkaktuar pala e paditur nga palës paditëse në gjykim, Bashkisë Pogradec. Nuk u provua lidhja shkakësore midis veprimeve dhe mosveprimeve të palës së paditur dhe dëmit të shkaktuar paditësit në formën e fitimit të munguar. Nuk u provua kundërligjshmëria e veprimeve dhe mosveprimeve të palës së paditur. Në përfundim, subjekti ka sqaruar se këtë vendim e ka dhënë bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon institutin e shkaktimit të dëmit, bazuar në ligjin për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike, si dhe bazuar në legjislacionin që rregullon fushën e prokurimeve publike. Kjo çështje aktualisht është në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Në referim të pikave 1 dhe 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim.”, informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas

kritereve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit.

Komisioni, pasi analizoi shtatë denoncimet e mësipërme, nga 38.1 deri në 38.7 sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte konkrete lidhur me veprime korruptive, apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit, dhe nuk gjeti indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

Komisioni vlerëson se bazuar pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka kompetencë të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

38.8 Denoncimi nr. 8

Denoncim anonim me nr. *** prot., datë 10.6.2019, i cili i është drejtuar për dijeni edhe vëzhguesit ndërkombëtar (ONM).

Objekti i denoncimit: Punësim nepotik të nëpunësve të administratës të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryetarit të gjykatës, ku referohen fakte se personeli është emëruar nga subjekti pa respektuar procedurat ligjore të rekrutimit dhe se një pjesë e personelit (këshilltari, arshivisti, sekretaret dhe shoferi) janë të afërm, të njohur të subjektit apo të bashkëshortes së tij. Gjithashtu, në këtë denoncim pretendohet edhe për abuzime me karburantin dhe përdorimin e tij për interesa privatë.

Lidhur me procedurat e rekrutimit, si dhe lidhur me deklarinimin e listëpagesave të punonjësve të gjykatës, Komisioni kreu një hetim¹, nga ku rezultoi se:

Për shtetasen V.P., sekretare gjyqësore, e cila sipas denoncuesit ushtron njëherazi funksionin e këshilltares së Këshillit Bashkiak Korçë, përfaqësuese e ***:

Është lidhur kontrata individuale e punës në datën 7.1.2015, pa procedura rekrutimi. Në kohën e lidhjes së kontratës ishte shfuqizuar ligji nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, mbi bazën e të cilit është bazuar edhe rekrutimi i kësaj punonjëseje.

Kontrata me sekretaren është lidhur pas afro dy viteve nga lëshimi i urdhrin nr. ***, datë 31.10.2013, të ministrit të drejtësisë, për emërimin në detyrë të sekretares gjyqësore.

Për sa më lart, duket se subjekti nuk ka kryer një procedurë për rekrutimin e sekretares gjyqësore, znj. V.P., me të cilën ka lidhur kontratën individuale të punës në vitin 2015, për arsye se në kohën e lidhjes së kësaj kontrate nuk ekzistonte ligji nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” (i shfuqizuar me vendimin nr. ***, datë 6.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese, hyrë në fuqi në datën 21.3.2014), mbi bazën e të cilit ishte lëshuar urdhri i ministrit për caktimin e saj si sekretare. Konstatimet sa më lart vlejnë edhe për sekretaren S.S. Në denoncim trajtohet se edhe shtetasi A.I., në detyrën e shoferit, është kushëri me subjektin.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

E gjithë procedura e rekrutimit të punonjësve të administratës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, është kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën e rekrutimit të gjithsecilit prej tyre. Asnjë prej punonjësve të administratës gjyqësore të rekrutuar prej tij si kryetar gjykate, nuk është i afërm apo i njohur i tij, apo i bashkëshortes së tij. Në auditimin e kryer nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor në vitin 2016, nuk janë konstatuar shkelje të legjislacionit në fuqi për procedurën e rekrutimit të punonjësve të administratës gjyqësore. Për këtë ka depozituar, në cilësinë e provës, shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2016, të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, lidhur me veprimtarinë e Gjykatës Administrative

¹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2019, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë dhe shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2019, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

së Shkallës së Parë Korçë, për periudhën e auditimit nëntor 2013 – 31.12.2015. Shtetasja V.P., nuk është rekrutuar në administratën e Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Korçë prej subjektit si kryetar gjykate, por është rekrutuar me urdhrin nr. ***, datë 31.10.2013, të ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë e ka rekrutuar këtë shtetase me detyrë sekretare gjyqësore, në bazë të kompetencës që i jepte ligji nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore”. Subjekti ka sqaruar se nuk ka kryer asnjë procedurë për rekrutimin e kësaj shtetaseje në administratën gjyqësore, për arsye se ka filluar detyrën si kryetar i kësaj gjykate në datën 4.11.2013, kohë kur kjo gjykatë filloi veprimtarinë e saj publike me ligj, ndërsa emërimi në detyrë si sekretare gjyqësore i shtetasës V.P., është bërë që në datën 31.10.2013, pra, disa ditë para urdhrin të ministrit të Drejtësisë. Ai ka pretenduar se në këtë rast, si punëdhënës në atë kohë me ligj i sekretares gjyqësore V.P., ka qenë ministri i Drejtësisë ai që nuk ka respektuar procedurën e parashikuar nga ligji nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore”, kur ka nxjerrë urdhrin nr. ***, datë 31.10.2013, për emërimin në detyrë të sekretares gjyqësore V.P., lidhur me procedurën e rekrutimit të saj. Në vijim, subjekti ka sqaruar se me vendimin nr. ***, datë 6.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese, u shfuqizua ligji nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese ka hyrë në fuqi në datën 21.3.2014. Pas shfuqizimit të ligjit nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, ligji që e rregullonte marrëdhënien juridike të punës së punonjësve të administratës gjyqësore (ashtu edhe të shtetasës V.P.), ka qenë Kodi i Punës, në kushtet e mungesës së rregullimit me një ligj të posaçëm të kësaj marrëdhënieje pune. Punëdhënësi i punonjësve të administratës gjyqësore nuk ishte më ministri i Drejtësisë, por kryetari i gjykatës. Në të tilla rrethana, referuar ligjit që e rregullonte këtë marrëdhënie, nenit 21/4, të Kodit të Punës, ka hartuar me shkrim kontratën e punës me secilin punonjës të administratës gjyqësore, përfshirë edhe shtetasen V.P. Kontrata e punës është lidhur me këtë shtetase në datën 7.1.2015, pikërisht për të zbatuar detyrimin që buronte nga neni 21/4 i Kodit të Punës, pas daljes së vendimit nr. ***, datë 6.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese (si rrjedhojë e të cilit ndryshoi ligji që e rregullonte marrëdhënien juridike të punës, si dhe punëdhënësi në rrethanat e sipërpërmendura). Në të tilla rrethana subjekti është shprehur se në datën 7.1.2015 ka hartuar kontratën individuale të punës me shtetasen V.P. Gjithashtu, subjekti është shprehur se kur ka hartuar kontratën e punës për këtë punonjëse nuk kishte ndonjë detyrim ligjor të respektonte ndonjë procedurë rekrutimi në datën 7.1.2015, marrëdhënia juridike e punës së të cilës kishte filluar që me urdhrin e emërimit të ministrit të drejtësisë.

Të njëjtat shpjegime, sikurse për shtetasen V.P., subjekti ka dhënë edhe për rekrutimin në punë të sekretares gjyqësore S.S., nga ministri i drejtësisë, me urdhrin nr. ***, datë 4.11.2013. Edhe për këtë sekretare gjyqësore, sikurse për të gjithë punonjësit e administratës së gjykatës, ka qenë i detyruar që në bazë të nenit 21/4 të Kodit të Punës të hartonte kontratën individuale të punës në datën 7.1.2015.

Lidhur me procedurën e rekrutimit në punë në pozicionin e “shoferit/mirëmbajtës” të shtetasit A.I., subjekti ka sqaruar dhe ka provuar me dokumentacion se se nuk ka asnjë lidhje familjare me këtë shtetas. Kancelari i gjykatës, me relacionin e datës 27.5.2014, ka propozuar emrin e shtetasit A.I., për pozicionin e lirë të punës si “shofer/mirëmbajtës”. Mbi bazën e këtij propozimi, me vendimin nr. *** prot., datë 28.5.2014, të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë është vendosur emërimi i z. A.I., si punonjës “shofer/mirëmbajtës” në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Në datën 28.5.2014 është lidhur kontrata e punës me punonjësin A.I., ku tre muajt e parë të punës janë cilësuar si periudha e provës. Subjekti ka përfunduar se në të tilla rrethana, në kushtet e mungesës së një ligji specifik ka përcaktuar me urdhër të kryetarit të gjykatës procedurën e rekrutimit të punonjësve të administratës së gjykatës.

Qëndrimi i Komisionit

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi prapësimet e subjektit, lidhur me procedurën e rekrutimit të sekretareve, mban qëndrimin se subjekti, në cilësinë e punëdhënësit si kryetar gjykate, nuk ka respektuar procedurat e caktuara të rekrutimit për rekrutimin e sekretarëve gjyqësore, në kushtet kur ligji nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, ishte shfuqizuar

me vendimin nr. ***, datë 6.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese, hyrë në fuqi në datën 21.3.2014. Procedurat e rekrutimit janë përcaktuar në urdhrin nr. *** prot., datë 25.3.2014, të kryetarit të gjykatës², referuar edhe nga vetë subjekti gjatë shpjegimeve për punonjës in A.I., për këtë periudhë.

Pretendimi i subjektit se nuk kishte detyrim të ndiqte procedurat e rekrutimit për plotësimin e nevojave me sekretare gjyqësore nuk është i sakte, për arsye se marrëdhënia e punësimit me sekretaret gjyqësore (V.P. dhe S.S.) ka nisur me lëshimin e urdhrave nga Ministri i Drejtësisë dhe kishte përfunduar me shfuqizimin e ligjit nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, për rrjedhojë, urdhrat e Ministrit të Drejtësisë (urdhri nr. ***, datë 31.10.2013, dhe urdhrin nr. ***, datë 4.11.2013), nuk duhet të kishin më vlerë ligjore. Për më tepër, argumenti i lidhjes së kontratës së punës në datën 7.1.2015 me sekretaret gjyqësore, mbi bazën e nenit 21/4³ të Kodit të Punës, nuk qëndron, pasi kjo dispozitë kërkon plotësimin e kushteve ligjore: ekzistencën e një marrëdhënie punësimi, e cila nuk është formalizuar në formë të shkruar për raste të veçanta dhe të justifikueshme (të arsyetuara me shkrim nga punëdhënësi), si dhe respektimin e detyrimit të lidhjes së kontratës brenda një afati të caktuar, që është brenda 7 ditëve nga punësimi.

Në rastin konkret, marrëdhënia e punësimit me sekretaret gjyqësore nuk ka ekzistuar për shkak të shfuqizimit të ligjit të lartpërmendur dhe, për rrjedhojë, referimi të kjo dispozitë si bazë ligjore nuk qëndron për lidhjen e kontratave individuale me sekretaret (e sipërtrajtuara). Gjithashtu, Komisioni vlerësoi shkresën e sjellë nga subjekti në cilësinë e provës (shkresa nr. *** prot., datë 21.9.2016, të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, lidhur me veprimtarinë e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për periudhën e auditimit nëntor 2013 – 31.12.2015), për të provuar se nuk janë konstatuar shkelje të legjisllacionit në fuqi për procedurën e rekrutimit të punonjësve dhe se ky akt, edhe pse përfaqëson një akt të auditimit të brendshëm, nuk vleftëson ligjshmërinë e procedurave të rekrutimit, por ka për objekt auditimin e zbatimit të ligjshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare.

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e Komisionit për denoncimin nr. 8, por duke mbajtur në konsideratë sa parashikohet nga vendimi nr. 2 /2017 i Gjykatës Kushtetuese: “*Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale*” vlerëson se sa u konstatua nga ky denoncim nuk shërben si provë për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ibi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

² Pjesë e praktikës së rekrutimeve, sipas shkresës nr. *** prot., datë 28.6.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

³ Neni 21 i Kodit të Punës.

Forma e kontratës së punës.

4. Për raste të veçanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk është lidhur sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë brenda 7 ditëve nga punësimi.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Ibi, me funksion gjyqtar/kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.9.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj